

REVISTA DITURIA ISLAME E KOSOVËS: DRITARE SHKENCE DHE INFORMIMI

*KOSOVO'S MAGAZINE DITURIA ISLAME : WINDOW OF
SCIENCE AND INFORMATION*

Refik GËRBESHI

MSc, Islamic Community of the Republic of Kosovo, Kosovo

 <https://orcid.org/0009-0008-4772-6622>

Abstrakt: Publicistika islame në gjuhën shqipe në Kosovë starton me vjetarin *Takvim* që në vitin 1945 kurse në vitin 1962 u botua *Buletini Informativ* e cila prej vitit 1970 u quajt revista *Edukata Islame* kurse në vitin 1986 doli revista *Dituria Islame*. *Dituria Islame* nga qershori 1986 - deri në gusht të vitit 1990, nxori 17 numra (katër dinumërsha) që në fillim kishte shkrime autoriale rreth besimit e shkencës islame si dhe përkthime nga gjuha arabe, angleze, turke, boshnjake, gjermane, e gjuhë të tjera. Fillimisht si revistë fetare-informative e paraparë të dalë çdo tre muaj, kurse më vonë ka edhe dy numërshë, e cila u dilte në ballë edhe propagandimeve ndaj Islamit dhe shqiptarëve. Revista *Dituria Islame* është bartëse kryesore e frymës, e ideve dhe vlerave islame në Kosovë dhe me gjerë, duke mos lënë anash edhe zhvillimet e kohës si ato kombëtare e politike të vendit tonë. Kjo revistë ka kaluar jo vetëm kufijtë kombëtarë, por ka depërtuar edhe në diasporën shqiptare nëpër Evropë. Shkrimet në këtë revistë janë të shumë zhanreve trajtime të ndryshme të çështjeve fetare, sociale, kulturore, shkencore, historike e arsimore. Në këtë revistë kishin hapësirë edhe shkrimet shkencore, historike, letrare e kulturore të trojeve shqiptare, këtu botonin shkrimet e tyre edhe profesorët universitarë, shkrimtarë, gazetarë e politikan. Edhe në trendin bashkëkohorë të zhvillimeve teknologjike të mediave, ekzistojnë me dhjetëra webfaqe e portale nëpër internet si faqe zyrtare e jo zyrtare, në të cilat informata shkencore ka mjaftueshëm.

Fjalët kyçe: Kosova, Periodiku islam, *Dituria Islame*, Shkencë, Informim

Abstract: Islamic journalism in the Albanian language in Kosovo started with the yearbook *Takvim* in 1945, and in 1962 the *Buletini Informativ* was published, which in 1970 was called the magazine *Edukata Islame* and in 1986 the magazine *Dituria Islame* was published. From June 1986 to August 1990, it published 17 issues (four double issues) which initially contained authorial writings about Islamic faith and science, as well as translations from Arabic, English, Turkish, Bosnian, German, and other languages. Initially as a religious-informative magazine intended to be published every three months, and later it also had two issues, which also came to the forefront of propaganda against Islam and Albanians. The magazine *Dituria Islame* is the main carrier of the spirit, ideas and Islamic values in Kosovo and beyond, not leaving aside the developments of the time such as the national and political ones of our country. This magazine has crossed not only national borders, but has also penetrated the Albanian diaspora throughout Europe. The writings in this magazine are of many genres, different treatments of religious, social, cultural, scientific, historical and educational issues. This magazine also had space for scientific, historical, literary and cultural writings of Albanian lands, university professors, writers, journalists and politicians also published their writings here. Even in the contemporary trend of technological developments in the media, there are dozens of websites and portals on the Internet as official and unofficial pages, in which there is sufficient scientific information.

Keywords: Islamic periodical in Albanian, *Dituria Islame*, Albanian Islamic culture



Corresponding author: Refik Gërbeshi, refikr.gerbeshi@hotmail.com



Citation: Gërbeshi, Refik. "Revista Dituria Islame e Kosovës: Dritare shkence dhe informimi." In *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, edited by Sevba Abdula, Ahmet Köroğlu, and Fatih Şabani, 137–154. Skopje: IDEFE Publications, 2025. <https://doi.org/10.51331/EB11RG>.

Hyrje

Allahu i lartësuar me mësimet e Tij shfaqi metodologjinë më të përkryer që ekziston, mënyrën graduale, dhe të shkruar. Fletushkat e librat datojnë që nga koha e Ibrahimit e Musait a.s. duke pasuar me librat deri tek shpallja e Kuranit, dhe shkrimi i tij.

Nga ana tjetër zgjerimi i mësimave të Zotit përmes shkrimeve të cilat Muhamedi (a.s.) u dërgoi perandorëve dhe sundimtarëve të ndryshëm. Periudha e korrespondencës me sundimtarët e vendeve të ndryshme ishte etapa e zgjerimit të hovshëm të njohurive për mësimet e Zotit. Kjo ndodhi kah fundi i vitit 6 h, me anë të këtyre mesazheve, Muhamedi (a.s.) ua ka paraqitur parimet e fesë islame sundimtarëve më të famshëm të asaj kohe. Në mesin e tyre, ka të atillë që e pranuam Islamin, e disa të tjerë mbetën në mosbesim. Mirëpo është me rëndësi fakti se edhe ata filluan të mendonin për Muhamedin (a.s.) dhe për Islamin. Në librat islame sqarohet se ishin tetë letra - mesazhe të tilla, të cilat janë të ruajtura në mënyrën që ne sot kemi mundësi t'i lexojmë dhe të marrim mësim. Se përhapja e Islamit, kishte edhe dimensionin e letrave e shkrimeve e shtypit e gazetave që drita e kësaj feje të futet çdo kund.

Edhe pse mesjeta njihet si kohë e errësirës për Evropën, në këto kohëra muslimanët hapnin shkollat dhe stimulonin shkencën dhe u zgjerua një rilindje të madhe kulturore. Gjithashtu u bë grumbullimi i librave të vjetra filozofike dhe përkthimi i tyre nga greqishtja, armenishtja dhe tekstet filozofike e mjekësore të helenizmit klasik të cilat u përkthyen në gjuhën arabe, kështu që i ndihmuan diturisë dhe përhapjes së saj.

Pra ardhja e muslimanëve në Evropë, në Andaluzi (Spanjë), vuri bazat e humanizmit e rilindjes, por kjo u zgjerua edhe në Ballkan tek ne duke u bërë masive në periudhën e Perandorisë Osmane e cila hapi shkollat, fakultetet e bibliotekat në territoret e saj.

Bartës të mësimave nga Zoti janë edhe shqiptarët ku vendosja e Islamit në pjesën më të madhe të vendit, tonë në shek. XVII, shënoi një kthesë rrënjësore në jetën shoqërore, kulturore e shpirtërore. Masivizimi i elementit islam dhe integrimi i shqiptarëve në Perandorinë Osmane, u mundësoi atyre të kontribuojnë në qarqet ushtarake, politike e shkencore. Kontributi i tyre vijon ndër shekuj dhe këto gjurmë janë prezentë edhe në shtypin e revistave apo gazetave gjegjësisht zhvillimit të publicistikës.

Zgjerimet e mësimave Islame dhe Avancimi i Shqiptarëve me të

Allahu i lartësuar i shpalli njeriut mësimet e Tij, për të udhëzuar në rrugën e drejtë të besimit, e urdhëroi të lexoi e mësoi por edhe të shkruaj. Betimi në lapsin dhe shkrimin është motiv për besimtarët që të mirën me shkrime. Siç thuhet në Kuran:

*“Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë!” (Kalem 1) **

وَالْقَلَمِ وَمَا يَسْطُرُونَ

Në kuadër të këtij betimi Muhamedi a. s. i urdhëronte shokët e tij që të shkruajnë, kështu që krahas nxënies përmendësh, shkrimi është njëra nga metodat e ruajtjes së Kur'anit dhe të Hadithit. Pastaj shkrimi i mesazheve dërguar liderëve të kohës, e cila mundësoi që; Pa u mbushur një shekull i plotë, jehona e shpalljes së mësimave kuranore që kishte nisur në Shpellën Hira, arriti në tri kontinente.¹ Mesjeta njihet si kohë e errësirës, por jo për muslimanët të cilët hapnin shkolla dhe stimulonin shkencën duke nxitur një rilindje të madhe kulturore. Në kohën e tij u bënë edhe përkthime të mëdha nga greqishtja, armenishtja dhe tekstet filozofike e mjekësore të helenizmit klasik.²

Grumbullimi i librave të vjetra filozofike dhe përkthimi i tyre në gjuhën arabe ishte orientim i shkencës, ku muslimanët hapën shkolla në shumë vende kurse polemikat mes dijetarëve ishin gjithnjë ngadhënjyese në të mirë të muslimanëve, ngase iu kishin përkushtuar me seriozitet shkencës dhe diturisë. Dijetarët islamë i tejkalonin ata në çdo fushë, si në Filozofi, Mjekësi, Astronomi, Shkencat natyrore etj. Për gjashtë shekuj muslimanët prinin në shkenca por edhe në ndërtime, tregti e qytetërim.³

Ardhja e muslimanëve në Evropë, pikërisht në Andaluzi (Spanjë), vuri bazat e humanizmit të rilindjes. Kurse gjatë viteve 969-1027, Kordova ishte një qendër e dijes.⁴

Kjo do të vazhdonte edhe në periudhën e Perandorisë Osmane e cila hapi shkolla, fakultete e biblioteka në territoret e saj, sidomos në pjesët e Ballkanit. Vendosja e Islamit në pjesën më të madhe të vendit, në shek. XVII, shënoi një kthesë rrënjësore në jetën shoqërore, kulturore e shpirtërore të vendit. Ky ndryshim i

1 Qemajl Morina, *E vërteta dhe paragjykimet për Islamin në botë dhe ndër Shqiptarët*, Në KBIK, Simpoziumi Ndërkombëtar: “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”, (Prishtinë, 1995), 29.

2 Karen Armstrong, *Islami - një histori e shkurtër*, (Shkup: Logos A, 2011), 108.

3 Sami Frashëri, *Përpjekja e Heronjve në përhapjen e Islamit*, (Shkup: Logos A, 2003), 20.

4 Armstrong, *Islami - Një histori e shkurtër*, cit., 23.

madh nuk mbeti pa lënë gjurmë të thella edhe në sistemin esnafor të përhapur në qendrat kryesore shqiptare.⁵

Por jo vetëm kaq, dijetarët myslimanë brez pas brezi u morën me shkrimin, komentimin, analizën dhe krahasimin e njohurive të ndryshme shkencore teologjike e shkenca të tjera. *Dituritë janë pjesë e pandarë e jetës islame dhe e përparimit historik të shoqërisë. Sa më lart të ngrihet shoqëria në shkallën e arsimit, aq më i përsosur është besimi. Ky është mesazhi i vërtetë i Islamit.*⁶

Mbështetur nga kjo premisë edhe ulemaja shqiptare u morën me ndriçime e studime të kulturës islame, por edhe kontribuan për ruajtjen e gjuhës, historisë dhe kulturës shqipe.

Shqiptarët bartës të islamit dhe ruajtës të identitetit

Kur Muhamedi a.s. ftonë në Islam tre nga fisnikët i thanë: “Jemi në mes nga të gjitha anët dhe arabët do të na shkatërrojnë, persët do të na luftojnë? Muhamedi a.s. u ka thënë: “Nuk e përhap fenë askush tjetër më mirë se sa ne që jemi në mes të pafeve.”⁷

Me ardhjen e Islamit, në Kosovë u bënë hapat e parë për zhvillimin e mësimave islame. Gjithashtu, shumë nga hoxhallarët Hoxh Kadri Prishtina, Mulla Adem Gjigolli, Myderriz Rustem Pllana, etj. (cilët? Jepni disa emra.) shkolloheshin në Stamboll dhe kontribuonin në edukimin dhe arsimimin e popullit. Perandoria Osmane me Kushtetutën 1876 dhe me ligje të veçanta, parashikonte që në çdo qytet e fshat të çelëshin shkolla filllore të detyrueshme për fëmijët e moshës 7-vjeçare, kurse nga viti 1883 ishte caktuar taksa e veçantë për financimin e arsimit.⁸

Masivizimi i elementit islam erdhi së bashku me integrimin në Perandorinë Osmane, e cila u mundësoi shqiptarëve të kontribuojnë në qarqet ushtarake, politike e shkencore. Edhe në shtypin e revistave apo gazetave gjegjësisht zhvillimit të publicistikës. Përkatësia fetare e popullsisë së këtyre viseve (Çamëri, Kosovë) ku mbizotëronte popullsia e besimit musliman si dhe lufta për ruajtjen e këtij besimi u bë faktor i rëndësishëm i qëndresës dhe një mjet i fuqishëm shprehës i përkatësisë kombëtare të popullsisë.⁹

5 Zija Shkodra, *Islami dhe institucioni esnafor në Shqipërinë etnike*, Në KBK, Simpoziumi Ndërkombëtar: “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”, cit., 139.

6 Sami Frashri, *Përpyekja...*, cit, 13

7 Amër Halid, *Gjurmëve të të Dashurit Tonë*, (Shkup: Furkan, 2006), 180.

8 Ali Riza Selmani, *Shkollat fetare islame...*, Në: “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”, cit., 134.

9 Lefter Nasi, *Aspekte nga kontributi...*, Në: “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”, cit, 474.

Në dritën e shkencës duhet të shihet edhe roli i Islamit si faktor integrues i njësisë etno-kulturore dhe gjeopolitike të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar, deri në fillimet e Rilindjes.¹⁰

Më zgjerimet e mësimave islame kombet e ndryshme përhapen edhe kulturën e tyre kombëtare si; Alfabeti, arkitektura etj. Vendosija e Islamit në pjesën më të madhe të trojeve shqiptare në shek. XVII, shënoi një kthesë rrënjësore në jetën shoqërore, kulturore e shpirtërore të vendit.¹¹ *“Depërtimi i turqve në Ballkan do të shkaktojë ndryshime të thella dhe të përhershme te të gjithë popujt e gadishullit, e në veçanti te populli shqiptar do të shkaktojë ndryshimet më të thella dhe më afatgjate.”*¹² Kjo periudhë pesëshekullore ishte kulmi i lulëzimit të islamit ndër shqiptarët, sidomos me reformat e fundit të cilat nuk arritën të realizohen tërësisht. *“Me reformën e sulltan Abdyl Mexhidit, në vitin 1856, u proklamua barabarësia e muslimanëve dhe jo-muslimanëve, si dhe mundësia më e madhe e hapjes së shkollave. Ky akt u realizua pjesërisht në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, kur u hapën në Vilajetin e Kosovës disa shkolla fillore e të tjera.”*¹³

Mësimi hyjnor nga Meka zgjerohet në Gadishullin Arab, duke ndriçuar Azinë, pastaj Evropën, Afrikën e Indinë dhe vjen deri tek populli i lashtë autokton i Ballkanit, Ilirët. Ky popull me krenari e barti këtë mision, jo vetëm në vendin e vet, por shkëndijat e bijve të shqiptarisë në përhapjen e dijes islame njihen edhe jashtë tokave të tyre duke filluar që nga Hoxha Tahsini, Shemsudin Sami Frashëri në Stamboll, Abdul Kadër Arnauti, në Sham Sulejman Gavoçi, Nasirudin Albani, Shuajb Arnauti, etj. në tokat arabe. Me vonë vargu i misionarëve islamo-shqiptarë vazhdon edhe në Amerikë të cilët organizonin jo vetëm vendet për falje, por edhe mësimin e gjuhës shqipe. Qendra Shqiptaro Islame e Amerikës cilësohet si: Qendra e aktiviteteve, qendra që themeloi një nga shkollat e para të shqipes. Ndër ta ishin imamë Isa Hoxha dhe Imam Vehbi Ismaili¹⁴

10 Dr. Muhamet Pirraku, *Roli i Islamit...*, në KBIK, Simpoziumi Ndërkombëtar: “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”, (Prishtinë, 1995), 43.

11 Refik Gerbeshi, *Mulla Irfan Bikliqi*, libër në dorëshkrim, 18

12 Menduh Bamja, *Pozita kushtetuese-juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi, me vështrim të posaçëm të bashkësisë islame* (Prizren, 2009), 26, 32.

13 Jashar Rexhepagiq, Shkollat dhe arësimi në Kosovë nga fundi i shekullit XVIII gjer me 1918, Enti i Historisë së Kosovës, Kosova, 1. (Prishtinë, 1972), 110

14 Derisa ishte me studime në Kajro rreth viteve 1940 merr një letër nga babai i tij ”...të këshilloj që të mos gabosh e të vish...” Prandaj mbetet atje, më 1949 shkoi në SHBA dhe puna e parë ishte gjetja e një lokali për faljen e namazit dhe mësimin e fëmijëve mbi islamin dhe gjuhën shqipe F.L., I.D., N.B. “NË KUJTIM TË BREZAVE”, (Shkodër 1997), 599

Kurse në Evropën e sotme shqiptarët përmes xhamive, shoqatave e hoxhallarëve ruajnë identitetin dhe e bartin Islamin, jo vetëm të bashkëkombësit e vet, por edhe ndër evropianë, ngase janë urë lidhëse e civilizimeve.¹⁵

Rrjedhat historike dhe kufizimi i të drejtës për shtypin islam në gjuhën shqipe

Pas tërheqjes së Perandorisë Osmane, popullata muslimane e mbetur nën pushtimin serbo-malazet ose grek, pas Luftës Ballkanike, u privua nga organizimi i mëtejshëm arsimor i besimit në gjuhën shqipe dhe institucionet arsimore kulturore të tij.¹⁶

Mirëpo popullsia shqiptare me shumicë islame kishte bazat e qytetërimit të ngritur me shekuj, mbi të cilat ruante identitetin e vet. Përpos infrastrukturës dhe arkitekturës islame, kishte edhe kuadrot e shkolluar që bënë përpjekjet e tyre për të ruajtur fenë dhe traditën islame. Shumë prej tyre, të specializuar në shkencat islame dhe të frymëzuar me ndjenjën fetare e kombëtare, kontribuonin dhe sakrifikonin për ruajtjen e tyre. Kultura dhe tradita islame kishte rrënjët e thella në popull dhe ishte e gjerë. Jo vetëm kontributi i tyre, por edhe vuajtjet që pësuan nga sistemi ateist komunist nuk përmenden në histori. Nga ana tjetër, neve dhe brezave në vijim, na bie barra që të bëjmë përpjekjet maksimale për të ndriçuar të vërtetën, punën dhe aktivitetet e tyre të zhvilluara me vështirësi të mëdha. Sa hoxhallarë të devotshëm, me të kaluar nga kjo botë, kanë mbetur në harresë dhe mendi i tyre tani nuk është i njohur, për vet faktin se brezat pas tyre u treguan të pakujdesshëm ndaj krijimtarisë së tyre.¹⁷

Interes të posaçëm shkencor e kombëtar paraqet kthimi, vështirimi dhe rivlerësimi i kontributit të disa figurave të shquara të fesë islame në mbrojtje të interesave kombëtare, kontribut i cili në të kaluarën, për shkaqe ideologjike komuniste, ishte lënë në harresë, ose ishte anatemuar.¹⁸

Krahas dhunës armike, Islami në Kosovë përballej edhe me propagandën ateiste përmes mediave, madje edhe shkollave, ku i gjithë procesi mësimor dhe

15 Refik Gerbeshi, "Islamin në diasporën shqiptare-Norvegji," Në *Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që Islami i përcjell në këtë integrim* (Tiranë, 2008), 165, 166.

16 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame të shqiptarët gjatë shekullit XX* (Tiranë, 2002), 27.

17 Sylejman Osmani, *Kontributi i Mulla sherif Ahmetit rreth Muhamedit as. Grup Autorësh, Haxhi Sherif ef.Ahmeti, Jeta dhe vepra (1920-1998)* (Prishtinë: KBIK, 2010), 39.

18 Lefter Nasi, *Aspekte nga kontributi i ulemasë shqiptare ...*, Në: "Feja, kultura dhe tradita islame ...,cit,f. 473.

edukativ, programet dhe lëndët mësimore do të përshkoheshin nga ideologjia komuniste. Po kështu është aplikuar presioni mbi mësimdhënësit, që t'ua prisnin agjërimin nxënësve. Fryma komuniste e shkollës, e publicistikës, e shkencës dhe e shoqërisë komuniste jugosllave në forma të ndryshme ngulfati identitetin musliman të shqiptarit.¹⁹

Sistemi komunist në luftën e ashpër kundër fesë përdori metoda e forma të ndryshme me projekt shtetëror. Këtë e bënte me reformën agrare, ku izolonte pronat, pastaj me burgosjen e hoxhallarëve, me mbylljen e mejtepeve dhe xhamive, duke i shndërruar në salla e depo mallrash. Institucionet që përfaqësonin fenë, paria fetare dhe besimtarët në përgjithësi, kanë qenë të shtypur dhe të kontrolluar. Shteti, herë pas herë, e ka kundërshtuar mësim-besimin, duke i mbyllur mektebet dhe duke bërë propagandë antifetare me sulme nëpër media ndaj thirrësve në fe (hoxhallarëve), duke i marrë në biseda informative.

U dogjën shumë qitapë (libra, literaturë islame) që u gjetën në shtëpitë e ulema-ve, jo të paktë në Kosovë.²⁰

Pas shkëputjes nga selia islame në Stamboll, jeta e organizuar fetare islame në viset shqiptare të pushtuara nga serbo-malazezët mund të thuhet se ishte paralizuar fare.²¹

Që nga viti 1930, nuk kishte asnjë shkollë në gjuhën shqipe, përveç disa shkollave që funksiononin tërësisht në mënyrë ilegale. Shqiptarët nuk kishin as shtypin në gjuhën amtare, ndonëse gati të gjitha pakicat tjera këto të drejta i gëzonin.²²

Çdo kërkesë për botimin e shtypit dhe qasjes në radio e televizion, organet shtetërore i kanë refuzuar me arsyetim se veprimtaria informative është e karakterit të përgjithshëm shoqërorë, me çka nënkuptohej se ato mund ta bëjnë vetëm institucionet shtetërore, të cilat janë të themeluara edhe për këtë qëllim.²³

Sistemi, i instaluar pas viteve 1945, ata që dinin shkrim-lexim arab e osman dhe

19 Rexhep Boja, *Për një të nesërme më të mirë* (Prishtinë, 2003), 72.

20 Hakif Bajrami, "Krimet dhe kriminelët në peshojën e ndërgjegjes njerëzore," *Dituria Islame*, nr. 70: 28.

21 Haki Kasumi, *Gjendja organizative ...*, Në: "Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët", cit., f. 460.

22 Gjermanët, hungarezët, çekët turqit, rusët kishin shkollat dhe shtypin e vetë. Sipas disa shënimeve shqiptarët ishin grup i dytë gjuhësor në vend, pas sllovenëve. Në politikën serbomadhe shqiptarët konsideroheshin serbë shqipfolës. Shih: Noel Malcom, Kosova, Një histori e shkurtër, "KOHA", Prishtinë, 1998, fq. 278-279.

23 Menduh Bamja *Pozita kushtetuese-juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi, me vështrim të posaçëm të bashkësisë islame*, Prizren, 2009, 290

nuk dinin apo nuk donin të mësonin shkrim-lexim në alfabetin cirilik, i quante analfabetë.²⁴

Në periudhën 1945-1950, në punën e shkollave tona në gjuhën amtare, meriton gjithsesi të vihet në dukje se ishin angazhuar afërsisht 240 hoxhallarëve në rolin e mësuesit : “Por megjithëkëtë, do t’i shënojmë ca, të cilët duhen veçuar edhe këta si pishtarë të merituar të arsimit tonë, disa nga të cilët i kam pasë vizituar edhe unë vetë nëpër shkollat e Kosovës, ku ata kanë pas shërbyer si mësues në atë periudhë të ndritshme fillestare.”²⁵

Pas Luftës së Dytë Botërore, edhe njëherë, Kosova futet dhunshëm nën administrimin e sajës artificiale, të quajtur Jugosllavi. Me këtë akt, Bashkësia Islame e Kosovës detyrimisht do të ndryshoi qendrën, nga Tirana në Sarajevë, dhe që prej vitit 1945 e deri më 1990, do të veprojë si Bashkësi e Fesë Islame me seli në Prishtinë, në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame të Federatës Jugosllave, me qendër në Sarajevë.²⁶

Gjatë vitit 1965 në RSFJ vjen deri te riorganizimi i pushtetit lokal, me ç’ rast suprimohen rrethet, me këtë edhe komisionet për çështje fetare të rretheve të cilat kanë funksionuar prej fundit të vitit 1959. Në bazë të propozimit të Komisionit federativ për çështje fetare, Këshilli Ekzekutiv Federativ i RPFJ, në bazë të Ligjit mbi themelimin e bashkësive fetare dhe mënyra e paraqitjes së ndryshimeve në statutet, në selinë dhe në udhëheqësit e bashkësive fetare, si dhe çështje që kishin të bënin me ndalimin e punës të bashkësive fetare, botimin të shtypit dhe të literaturës fetare etj.²⁷

Në këndvështrimin e shkallës së diturisë, Islami luajti rol shumë të rëndësishëm, sidomos në edukimin dhe arsimimin e muslimanëve, nga fakti se hoxhallarët ishin të vetmit që dinin shkrim e lexim. Ata ndiqnin shkolla e kurse pedagogjike dhe angazhoheshin në zhdukjen e analfabetizmit apo edhe direkt nëpër shkolla si mësues. “Në këtë periudhë, një numër i madh i ulemave petkun e profesionit e zëvendësuan me petkun mësuesit”.²⁸

24 Refik Gerbeshi, *Mulla Hashim Kuleta Pishtar i arsimit në Llap* (Prishtinë, 2024), 67

25 Po aty, f.108

26 Ramadan Shkodra, *Hfz. Bajram Agani - nismëtar...*, në KBK. Myderriz Hfz. Bajram ef. Agani – cit., f. 39.

27 Menduh Bamja, *Pozita kushtetuese-juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi*, cit, 298

28 Nuredin Ahmeti *Gjurmëve të veprimtarisë arsimore në gjuhën shqipe*, Në: Grup Autorësh, Muderiz, Sadri ef. Prestreshi-Jeta dhe vepra (1917-2002) (Prishtinë, 2013), 96

Në ato kohëra kur propaganda komunistë ishte në kulm. Në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të bashkësisë fetare islame në Kosovë, bën pjesë edhe shtypi fetare, i cili përveç që luante rolin propagandistik për fenë, trajtonte edhe çështje të ndryshme tematikë sociale dhe politike.²⁹

Në kohën kur në shtypin ditor dhe në atë periodik, në mënyrë të vrazhdë e tendencioze, vazhdimisht akuzohej feja dhe institucionet e saj veçmas ato islame, ndërsa gjeneratat e reja ishin të indoktrinuara nga propagandat anti islame, ku kishte formuar botëkuptim të gabuar ndaj Islamit. Sistemi komunist në luftën e ashpër kundër fesë përdori metoda e forma të ndryshme varësisht nga kushtet historike dhe nga etapat e ndërtimit të sistemit politik monist.³⁰

Në këto rrethana të krijuara edhe në viset e tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë, në organizimin dhe funksionalizimin e Bashkësisë së Fesë Islame në ish-Jugosllavi, më 1947 miratohet Kushtetuta dhe krijohen bazat ligjore për organizimin e Bashkësive Islame në nivelin qendror dhe në atë lokal. Sipas kësaj Kushtetute, formohet edhe Bashkësia e Fesë Islame me seli në Prishtinë, që administrimin e bënte në gjuhën shqipe.

Rifillimet Shtypi Islamë në gjuhën shqipe në Kosovë (1971-1990)

Kosova kishte trashëguar një fond shumë të pasur me dorëshkrime e libra në gjuhët orientale. Por, më 24 shtator 1951, do të themelonte “Bibliotekën Qendrore të Vakëfit” në Prishtinë, që njihej edhe me emërtimet “Kutubhaneja e Vakëfit” ose shkurt “Biblioteka e Vakëfit”.³¹

Kutubhaneja e Vakëfit asokohe kishte 2.092 njësi bibliografike (qitapë) në gjuhët arabe, turke, persiane dhe boshnjake. Prej tyre, 476 rezulton të kenë qenë dorëshkrime të vjetra që u takonin fushave të ndryshme shkencore fetare islame.³²

Shqiptarëve në përgjithësi gjatë sistemit komunist-ateist, iu ishte ndaluar që të shkruanin për fenë dhe rreth fesë, edhe pse në mesin tonë kishte hoxhallarët cilët kishin mundësi që ta bënin këtë.³³

29 Fahrush Rexhepi, *Kontributi i klerit islam në përpjekje për zgjedhjen shqiptare 1941-1945*, cit, 94

30 Zekerija Bajrami, *Shqiptaret dhe laicizmi postmodern*, 2 “Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që Islami i përcjell në këtë integrim” (Tiranë, 2008), 160.

31 Sadik Mehmeti, *Hafiz Bajram ef. Agani - themelues i Bibliotekës Qendrore të Vakëfit në Prishtinë (1951-1959)*, Grup Autorësh, Myderriz Hfz. Bajram Agani – cit, , f. 51.

32 Po aty, f. 59.

33 Naim ef.Tërnav, *Ligjërime për Fenë e Atëdheun 2* (Prishtinë, 2015), 95.

Në vitin 1947 mbyllen të gjitha shkollat fetare - medresetë, rrënohet një numër i madh i xhamive, sekuestrohet mbi 95% e pasurisë vakëfnore nga ish-sistemi komunist dhe shndërrohen në stalla e depo. Mejtepet (shkollat fillore fetare muslimane) ishin mbyllur, kurse të mësuarit e fëmijëve nëpër xhami u konsiderua si vepër penale e ndaluar me ligj, që më 1950.³⁴ Botimi i mirëfilltë i mediave të shtypura në Kosovë fillon pas Luftës së Dytë Botërore, veçmas në gjuhën shqipe, i cili fillon më, 12 shkurt 1945, kur botohet numri i parë i gazetës “Rilindja”. Po në këtë vit nis të botohet fletushka për rini “Zani i rinisë” pastaj nga viti 1946, fletushka për fëmijë “Pioneri” revista për letërsi “Jeta e re” ndërsa “Shëndeti” nga viti 1953. Në vitin 1970, revista për gra “Kosovarja” edhe revista për student “Bota e re”, kështu në vitin 1985 në Kosovë botoheshin 42 revista javore, 3 një mujore, 4 dymujore dhe 2 tremujore.³⁵

Në Jugosllavi pas vitit 1945 doli një numër mjaft i madh botimesh fetare muslimane kryesisht në serbokroatisht por ndonjë edhe shqip. “Bilten Udruzhenja istine Prishtinë” në shqip më vonë do të quhet “Edukata Islame: revistë fetare tremujore Prishtinë, pas vitit 1973 tremujore në shqip organ zyrtar i komunitetit musliman shqiptar në jugosllavi”.³⁶

Sistemi komunist kontrollonte të gjitha veprimtaritë shoqërore dhe censuron-te çdo vepër që botohej, andaj kërkohej kujdes i posaçëm sepse shumë lehtë mund të kishte pasojat negative dhe të shkaktohej ndërprerja e botimit të mëtejme. Përveç rrethanave të vështira populli në Kosovë, ballafaqohej edhe me mungesën e kuadrove dhe kushteve ekonomike që e shoqëronin BIK-un. Me dobësimin e ateizmit, aktivitetet islame e kombëtare u ringjallën. Në fund të viteve 80ta struktura e Bashkësisë Islame u përforcua me kuadro të rinj, por edhe sistemi komunist filloi të dobësohej, kështu që erdhi deri te funksionimi më i denjë. Me gjithë kushtet e vështira ekonomike e sociale, krerët e Bashkësisë Islame në Kosovë bënë përpjekjet serioze për përparimin e punës. Shtypi islam në gjuhën shqipe në Kosovë ishte një rilindje që sjell më afër njohuritë për fenë, është një dave e shkruar por edhe është një tribunë ku paraqiten mendimet shkencore filozofike islame. Por, edhe ato shoqërore e politike me të cilat preokupohej populli i Kosovës. Botimi i revistave të para, si “Buletini” dhe “Edukata Islame” ishin sukses i madh i Bashkësisë Islame të Kosovës, në ato kohëra kur propaganda komuniste ishte në kulm. Në kohën kur në shtypin ditor

34 Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë, 2010, f. 335.

35 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Fjalori enciklopedik i Kosovës, I, A-K, (Prishtinë, 2018), 671.

36 Aleksandre Popovic, *Islamizmi ballkanik, Myslimanët e Evropës Juglindore gjatë periudhës pasosmane*, perkthyen: Dritan Egro, Sokol Haxhimusaj, “Dituria” 2006, 436.

dhe në atë periodik, në mënyrë të vrazhdë e tendencioze, vazhdimisht akuzohej feja dhe institucionet e saj veçmas ato islame, ndërsa gjeneratat e reja ishin të indoktrinuara nga propagandat anti islame, ku kishte formuar botëkuptim të gabuar ndaj Islamit. Në vitin 1957, Bajram ef. Agani së bashku me Mehmet Gjevorin botuan të përkthyer “Ilmihalin” dhe “Jasin Sherifin”, botime këto që shënjuan fillimin e veprimtarisë botuese islame në gjuhën shqipe, në ish-Jugosllavi. Botimet e para nga Bashkësia Islame, gjegjësisht Sherif Ahmeti me “Ilmihalin”, “Jasini” dhe suret e shkurtra, Mevludi e të tjera

Roli dhe kontributi i shtypit islam në gjuhën shqipe

Fillimet e shtypit islam në gjuhën shqipe, në Kosovë arrihen në vitin 1962, kur filloi të shtypet publikimi tremujor i Shoqatës së Ulemave në Prishtinë, “Buletini informativ” i cili për 5 vite u botua në dy gjuhë (shqipe dhe serbokrate) e prej vitit 1966-67, vetëm në gjuhën shqipe.

Kurse Shoqata e Ulemave, në krye me H. Sherif Ahmetin në fund të vitit 1969, botoi takvimin-Kalendarin për vitin 1970.³⁷ Përveç pjesës kalendarike “Takvimi” kishte edhe tematika të ndryshme nga shumë autorë vendas e të huaj përmes përkthimeve. *Në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të bashkësisë fetare islame në Kosovë, bën pjesë edhe shtypi fetare, i cili përveç që luante rolin propagandistik për fenë, trajtonte edhe çështje të ndryshme tematikë sociale dhe politike.*³⁸

Prej vitit 1965, shtypi filloi të marrë një strukturë të shumëllojshme, sidomos me botimin e publikimeve periodike me karakter të specializuar. Më vonë duke filluar prej vitit 1968 e këtej, shtypi filloi të zhvillohet në të gjitha komunat e zhvilluara të Kosovës, duke filluar së pari prej buletineve e pastaj edhe gazetave dhe revistave.³⁹

Në vitin 1975, shoqata e nxënësve të Medresesë botoi revistën “Nur-Drita e Kur’anit” me tematika nga të rinjtë dhe për të rinjtë.

Numri i revistave dhe gazetave së bashku me botimet e librave filloi të funksionalizohet dhe të ketë një përmbajtje të frytshme për edukimin e masës. Pas revistës “Edukata islame”, e cila botohej në Prishtinë, në vitin 1971, botohet edhe revista “Nur-Drita e Kur’anit”, e cila është revistë e Medresesë “Alauddin” dhe e cila filloi botimin që nga viti 1978. Pason botimi i revistës “Dituria Islame”, që nga viti 1986.

37 Hajrulla Hoxha, *Fillimet e shtypit islam në Kosovë dhe zhvillimi i tij*, Në: “Shtypi Islam dje, sot dhe nesër” cit., 16.

38 Fahrush Rexhepi, *Kontributi i klerit islam në përpjekje për zgjedhjen shqiptare* cit., 94.

39 Sherafedin Hoxha, “Shtypi i Kombeve dhe Kombesive të Kosovës (1871-1983),” *Rilindja* (1987): 175

Media e shkruar fetare shqiptare shënoi një zhvillim të rëndësishëm qoftë në llojshmërinë e gazetave dhe revistave, qoftë edhe në përmbajtjen dhe tematikat që trajtonte. Duke përfshirë jo vetëm tematikat fetare por edhe çështjet e ndjeshme shoqërore

Ekzistojnë shumë revista islame në gjuhën shqipe, të cilat botohen në trojet shqiptare, e tillë është edhe Revista “Hëna e Re”, e cila është revistë e Bashkësisë Fetare Islame e Maqedonisë. Është informative, kulturore, islame, e cila botohet që nga viti 1987, edhe atë në tri gjuhë: shqip, maqedonisht dhe turqisht. Bashkësia islame fetare, përveç gazetave, botonte edhe libra, kalendarë, broshura dhe literatura tjera me tematikë fetare. Të këtij karakteri janë edhe gazeta “Buletini”, Edukata Islame, Takvimi që botoheshin në gjuhën shqipe dhe Ilmihali, Jasini Sherif, Mevludi etj.⁴⁰

Shtypi islam në gjuhën shqipe u mundësonte hoxhallarëve të kohës që të prezantoheshin me punimet e tyre, mendimit islam shqiptar ngase mbloodhi dijetarët dashamirë të mendimit islam në gjuhën shqipe. përmban tematika të ndryshme fetare, historike e sociale.⁴¹

Revista “Dituria Islame” dritare e publicistikës dhe informimit (1986-1990)

Kryesia e BIK-ut në vitin 1986, vendosi për botimin e revistës “Dituria Islame” fillimisht si revistë fetare-informative e paraparë të dalë çdo tre muaj, kurse më vonë ka edhe dy numërshe, i cili përsëritet gati çdo vit. Por kjo revistë është revistë mujore.

Revista “Dituria Islame” është një dritare shkencore, kulturore dhe informative që në fillim kishte shkrime autoriale, rreth besimit e shkencës islame si dhe përkthime nga gjuha boshnjake, gjuha arabe, gjuha angleze, gjuha turke e gjuhë të tjera. Duke ditur se është prej revistave të para islame në gjuhën shqipe, pas Luftës së Dytë Botërore është si sinjal i rënies së Komunizmit dhe futjes së Bashkësisë Islame në rrjedhat shoqërore, kulturore e politike. Kjo revistë është organ i Bashkësisë Islame të Kosovës, përmes së cilës paraqiteshin informata, shkrime të ndryshme autoriale të hoxhallarëve tanë por edhe të intelektualëve të kohës.

Dituria Islame e periudhës qershor 1986 - qershor 1993, gjatë redaksisë së parë, deri në gusht të vitit 1990, nxori 17 numra (katër dy numërshe). Redaksia e

40 Haki Kosumi, *Bashkësitë fetare...* 147-149.

41 Refik Gerbeshi, *Muderriz Bajrush Ahmeti*, Liber ne doreshkrim, 5.

tanishme, nga tetori 1990 deri në këtë numër Jubilar, nxori 33 numra (dy dy-numërsha) dhe një botim special.⁴²

Revista e pare për kulturë e shkencë islame shqiptare në Kosovë, e cila sjell informacion për aktivitetet jo vetëm të Bashkësisë Islame, por edhe nëpër disa xhami me mësim-besim, meremetimet dhe ndërtimet e reja. Revista “Dituria Islame” është bartëse kryesore e frymës, e ideve dhe vlerave islame në Kosovë dhe me gjerë, duke mos lënë anash edhe zhvillimet e kohës si ato kombëtare e politike të vendit tonë e më gjerë, ishte dritare informimi sidomos gjatë periudhës së dekadës së fundit të shekullit të kaluar, kur mediat kosovare ishin të ndaluara.

Revista “Dituria Islame” ka kaluar jo vetëm kufijtë kombëtarë, por ka depërtuar edhe në diasporën shqiptare nëpër Evropë. Shkrimet në këtë revistë janë të shumë zhanreve trajtime të ndryshme të çështjeve fetare, sociale, kulturore, shkencore, historike e arsimore. Që në numrin e parë reviste sqaron se ndër të tjera i dedikohet “Por njëkohësisht do të sjellim edhe artikuj nga përmbajtja e mësimi islam nga historia e zhvillimit të jetës fetare si dhe problemet me të cilat po ballafaqohet (Shoqëria) në jetën e përditshme të kohës”⁴³

Me përkthime nga gjuha arabe, boshnjake e turke si edhe me shkrime autoriale kjo revistë i qaset tematikave të kohës dhe në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe dobisë së përgjithshme të shoqërisë duke bërë thirrje të hapur për dashamirët e pendës e shkrimit që ti kontribuojnë kësaj fushe të rëndësishme historike duke argumentuar ndërtimin e xhamive, zhvillimin e aktiviteteve me të rijnë e manifestime të ndryshme që organizoheshin brenda dhe jashtë Kosovës. Në numrin e pestë me radhë dituria lajmëron për revistën si motër “El hilal” duke lajmëruar për zgjerimet e epokës së shtypit islam në gjuhën shqipe.⁴⁴

Prezantimi i shkrimeve nga dijetarët e mëdhenj islam, por edhe shkrimet autoriale me emra të njohuritë publicistikës islame në gjuhën shqipe por edhe fillojnë paraqitjet e autorëve të rijnë Këtu i kam të botuara edhe poezitë e mia të para.⁴⁵

Andaj “Dituria...” ka vijuar kursin e të qenit pjesë e pandashme e kornizës kulturore shqiptare, ashtu që në të janë faktorë kreativiteti në zhvillimet që kanë të bëjnë me vlerat e përgjithshme identitare kombëtare dhe aspak nuk i janë shmangur këtij diskursi kombëtar.⁴⁶

42 *Dituria Islame*, nr. 50 (1993): 3.

43 Fjala e Redaktorit, *Dituria Islame* nr. 1 (1986): 3.

44 A.A., “Edhe një revistë e re ‘El hilal,’” *Dituria Islam*, nr. 4-5 (1987): 34.

45 *Dituria Islame*, nr. 13/14 (1990): 43.

46 Rexhep Suma, *Revista Dituria Islame (1986-2020) Monografi*, e cit., 31.

Sidomos pas viteve 1990, revista “Dituria Islame” i shërbeu publicistikës Islame e shqiptare në Kosovë, duke u ofruar mundësinë e botimit të shumë punimeve me rëndësi e vlera shkencore e historike, por edhe si informatorë i zhvillimeve në vend. Në këtë hambarë të shtypit Islam, në gjuhën shqipe kishin hapësirë edhe shkrimet shkencore, historike, letrare e kulturore të trojeve shqiptare, këtu botonin shkrimet e tyre edhe profesorët universitarë.

Revista “Dituria Islame” ishte dritare e informimit në gjuhën shqipe, në kohën më të vështirë të mediave në Kosovë. “Sikurse në vitet nëntëdhjetë ku e tëra u vu në funksion të informimit të opinionit. Si të thuash e mori rolin e një reviste informative, ku denonconte dhe informonte për dhunën që pushteti serbë ushtronte mbi shqiptarët”.⁴⁷

Revista “ Dituria islame” Arkiv i zhvillimeve në Kosovë

“Dituria Islame” i linte hapësirën e mjaftueshme aktiviteteve të Mësim-besimit islam për fëmijët nëpër xhami kishte filluar të zgjerohej, siç ishte informimi për duatë e hatmeve, apo promovimin e hafëzëve, përmes së cilave mbaheshin programe të larmishme fetare, apo promovimet e nxënësve dhe imamëve të dalluar në këto aktivitete. Në kuadër të BIK-ut, përfshiheshin edhe aktivitete në Kosovën Lindore, siç ishte “Duaja e hatmes” në fshatin Dobrosin të Bujanovcit,⁴⁸

Kurse në vitet kur pushteti serb mbylli shkollat shqipe, nëpër xhami mbahej mësimi i shumë shkollave të mesme anë e kënd Kosovës. Paralelisht zhvilloheshin edhe takimet e ndryshme politike e popullore, siç ishte pajtimi i gjaqeve, zgjedhjet e politike e takime të shumta kombëtare.

Revista “Dituria islame”, fillimisht si revistë fetare-informative-tremujore, doli në qershor të vitit 1986. Fillesat dhe qëllimi i saj përmenden që në numrin e parë, ku thuhet se ajo ka për qëllim t’i ofrojë lexuesit informata lidhur me nevojat e BI-së, lidhur me problemet e saj të përditshme, që opinioni të njihet drejtpërdrejt me arritjet e BI-së dhe me gëzimin e të drejtave të tyre fetare. Ishte nevojë jetike e kahershme, por fillimisht mungonin baza ekonomike dhe kuadri profesional në fushë të fesë, të kulturës e të shkencës islame ndër shqiptare. Ekzistonte edhe shumë pengesa, pjellë e sistemit monist-komunist dhe mungesa e mirëkuptimit shoqëror shqiptar në përgjithësi.⁴⁹

47 Naim Tërnavë, “Dituria Islame, një tribunë e mendimit fetar e kombëtar,” *Dituria Islame*, nr. 313 (2016): 5.

48 Rexhep Luma, “Në Kaçanik edhe një hëviz i ri”, 26. Shih , *Dituria Islame*, nr. 2 (1986): 29.; *Dituria Islame*, nr. 6 (1987): 31.; *Dituria Islame*, nr. 3 (1986): 29.

49 Numri 50 Jubilar, Redaksia, 3, *Dituria Islame*, nr. 50, (1993).

Për informim të publicistikës ekzistonte rubrika “Për bibliotekën tuaj”, ku revista lajmëronte për librat e rinj, botimet e shumta nga Bashkësia Islame kishin filluar të shpërndareshin nëpër libraritë islame, nëpër qytete të ndryshme të Kosovës. Informata nga mërgata jonë ku zhvillohen aktivitetet islame, siç janë festat familjare, e kombëtare. Për Muajin e Ramazanin marrin nxënës nga medreseja që i strehojnë dhe i shpërndajnë nëpër xhami të vogla të rrethinës, për kryerjen e detyrave fetare.

Revista Dituria Islame paraqet gjendjen reale të komunitetit islam në Kosovë dhe më gjerë duke filluar me falja e Bajramit si ngjarje kulminante dhe disa reagime të atyre që nuk ju pëlqen.⁵⁰

Në mbrojtje të kauzës Islame e shqiptare revista “Dituria Islame i qaset disa çështjeve me rëndësi të qëndresës dhe ruajtjes së identitetit. Më ç ‘rast duke shfletua rikujton zhvillimet e kohës kur ne ishim fare të rinjë dhe guximin që kishte revista në ato kohëra të vështira për t’iu qasur këtyre tematikave. Vijon me kauzën kombëtare me diferencimet që u bëhen shqiptarëve në ato kohëra (1980-1990) dhe paralajmërimet për një epokë të re të shoqërisë Kosovare të cilat vërehen në diturinë islame pas ndalimit të Gazetës Rilindja, RTP-së, burgosje aktivistëve dhe ruajtja e manifestimit historik e politik të 2 Korrikut. Dituria Islame merr rolin e një dritareje informative me shkrime të shkurtra informative⁵¹ prej këtu fillon etapa tjetër me ndërrimin e kryesisë së BIK dhe redaktorit të revistës 20 numra për katër vite.

Revista “Dituria Islame” deri tash është revista më afatgjate, shumëdimensionale, shkencore islame e shqiptare me një shtrirje të gjerë hapësinore dhe periodeke. Ajo shtrihet gjithandej ku ka shqiptarë dhe nga fillimi i botimit të saj, nga shekulli i kaluar vazhdon ende të botohet duke hyrë kështu në dekadën e pestë të saj. Është një revistë mujore e rrallë herë dymërvshme (një herë në vit) gjithnjë duke u avancuar si në aspektin profesional ashtu edhe në atë teknologjik.

Përfundim

Zhvillimi i shtypit islam, i mediave dhe rrjeteve sociale në gjuhën shqipe duhet të jetë më aktiv, më aktual dhe më serioz, sepse përfshinë hapësirë globale dhe ai dëgjohet dhe përcillet nga njerëz që u takojnë kulturave dhe civilizimeve të ndryshme. Prandaj, shtypi islam që Në mënyrë që të realizoi me sukses misionin e tij, është e rëndësishme të përcaktohen ne frymën e mirëkuptimit, harmonisë ngase atakohet me shumë kultura civilizime e botëkuptime shoqërore.

⁵⁰ *Dituria Islame*, nr. 15/16 (1990): 3.

⁵¹ *Dituria Islame*, nr. 15,16 dhe 17 (1990).

Që pas Luftës së Dytë Botërore, Bashkësia Islame, si pjesë e këtij nën qielli, u ballafaqua me vështirësi të mëdha, por i bëri ballë ruajtjes së fesë dhe traditës shekullore. Andaj, si institucion dhe hoxhallarët si individë, së bashku me besimtarët në përgjithësi, janë faqebardhë para historisë.

Revista “Dituria Islame” ishte dhe është një revistë shkencore, kulturore islame e shqiptare, e guximshme dhe dritare për shkencë e informim. Që në numrin e parë i qëndroi pa lëkundur misionit të sajë e sidomos gjatë periudhës kur u mbyll shtypi në Kosovë.

Kjo revistë i qaset tematikave të kohës dhe në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe dobisë së përgjithshme të shoqërisë në mbrojtje të kauzës Islame e shqiptare revista “Dituria Islame” i qaset disa çështjeve me rëndësi të qëndrësës dhe ruajtjes së identitetit. Me ç’rast paraqiten me shkrimet e tyre akademikët, profesorët universitarë, shkrimtarët, gazetarët e politikanët e Kosovës me shkrimet e tyre.

Revista Dituria Islame paraqet gjendjen reali të komunitetit islam në Kosovë dhe më gjerë kështu por edhe me shkrimet sociale e politike që përmbanin edhe informata për zhvillimet e kohës lidhur me diferencimet që u bëhen shqiptarëve me një fjalë paralajmërimet për një epokë të re të shoqërisë Kosovare të cilat vërehen në diturinë islame ndalimi i RTP, burgosje aktivistëve dhe ruajtja e manifestimit historik e politik të 2 Korrikut. Duke vazhduar kështu deri në përfundimin e luftës.

Gjurmët e tyre kanë mbetur të botuara në letër por organizatorit do ti sugjeroja që të përfshijë edhe nëntë vite në këtë periudhë ngase tek ne e sidomos në Kosovë 1999 është përfundimi i luftës dhe fillimi i një etape të re.

Shkrimi, argumentimi dhe ndriçimi i zhvillimeve islame në Kosovë, dhe jo vetëm sidomos pas periudhës së luftës së Dytë botërore deri në vitin 1990, na mbetet obligim ngase me një anë kemi takuar protagonistët dhe kemi dëgjuar për sfidat e tyre e në anën tjetër jemi edhe bartës e vazhdimësi të aktiviteteve të intelektualëve tanë në përgjithësi. Hulumtimi dhe ndriçimi i inserteve të ndryshme me interes fetarë e kombëtarë është i pa shmangshëm për ne andaj ju përgëzoj për këtë iniciativë dhe mundësi që na keni dhënë.

LITERATURA

- Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. 2018. Fjalori enciklopedik i Kosovës, I, A-K, Prishtinë.
- Armstrong, Karen. 2011. *Islami - një histori e shkurtër*, Logos A: Shkup.
- Basha, Ali M. 2002. *Islami në Shqipëri nëpër shekuj*, Tiranë.
- Bamja, Menduh. 2009. *Pozita kushtetuese-juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi, me vështrim të posaçëm të bashkësisë islame*, Prizren.
- Boja, Rexhep. 2003. *Për një të nesërme më të mirë*, Prishtinë.
- Frashëri, Sami. 2003. *Përpyekja e Heronjve në përhapjen e Islamit*, Logos A: Shkup.
- Gerbeshi, Refik. 2024. *Mulla Hashim Kuleta Pishtar i arsimit në Llap*, Prishtinë.
- Gerbeshi, Refik, *Mulla Irfan Bikliqi*, libër ne dorëshkrim.
- Gerbeshi, Refik, *Muderriz Bajrush Ahmeti*, liber ne dorëshkrim.
- Halid, Amër. 2006. *Gjurmëve të të Dashurit Tonë*. Furkan: Shkup.
- Malcom, Noel. 1998. *Kosova, Një hitori e shkurtër*, KOHA: Prishtinë.
- Përmbledhje kumtesash. 2012. *Myderriz Hasan Ef. Nahi jeta dhe vepra (1905-1991)*, Dituria Islame: Prishtinë.
- Përmbledhje kumtesash. 2015. *Myderriz Hfz. Bajram Agani jeta dhe vepra (1899-1962)*, Dituria Islame: Prishtinë.
- Përmbledhje kumtesash. 2013. *Myderriz Sadri Ef. Prestreshi jeta dhe vepra (1917-2002)*, Dituria Islame: Prishtinë.
- Përmbledhje kumtesash, 2008. *Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që Islami i përcjell në këtë integrim*, Tiranë.
- Përmbledhje kumtesash, 1995. KBIK, *Simpoziumi Ndërkombëtar: Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*, Prishtinë.
- Përmbledhje kumtesash, KBIRK *Shtypi islam dje, sot dhe nesër*, Përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore, Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë, 2005, *Përmbledhje punimesh Haxhi Sherif ef. Ahmeti jeta dhe vepra (1920-1998)*, (Përmbledhje kumtesash), Prishtinë, 2010. *Boton: Bashkësia Islame e Kosovës-Shtëpia botuese "Dituria Islame"*.
- Rexhep Suma, Rexhep. 2020. *Islami dhe identiteti nga prespektiva e shtypit islam*, Logos: Prishtine.
- Popovic, Aleksandre. 2006. *Islamizmi ballkanik, Myslimanët e Evropës Juglindore gjatë periudhës pasosmane*, përkthyer: Dritan Egro, Sokol Haxhimusaj, Dituria.
- Rexhepagiq, Jashar. 1972. *Shkollat dhe arësimi në Kosovë nga fundi i shekullit XVIII gjer me 1918*, Enti i Historisë së Kosovës: Kosova, 1. Prishtinë.
- Skëndi, Eqber. 1992. *Hoxhë Kadri Prishtina*.
- Rexhepi, Fahrush. *Kontributi i klerit islam në përpjekje për zgjedhjen shqiptare 1941-1945*.
- Revista "DITURIA ISLAME" Nr. 1-20 1990 Boton Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë.
- Tërnavë, Naim ef. 2015. *Ligjerime për Fenë e Atëdheun*, 2, Prishtinë.
- Sherafedin Hoxha, Sharafedin. 1987. *Shtypi i Kombeve dhe Kombesive të Kosovës, (1871-1983)*, Rilindja: Prishtinë, 1987.
- Zekaj, Ramiz. 2002. *Zhvillimi i kulturës islame të shqiptarët gjatë shekullit XX*, Tiranë.